

VENDIM
Nr.540, datë 27.7.2005

PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT TË SESIONIT TË TRETË, TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT SHQIPTARO-AUSTRIAK, PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit të sesionit të tretë, të Komisionit të Përbashkët Shqiptaro-Austriak, për bashkëpunimin ekonomik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

PROTOKOLL

**I SESIONIT TË TRETË TË KOMISIONIT TË PËRBASHKËT SHQIPTARO-AUSTRIAK
PËR BASHKËPUNIMIN EKONOMIK**

Sesioni i tretë i Komisionit të Përbashkët shqiptaro-austriak për bashkëpunimin ekonomik u zhvillua në Vjenë më 11-12 prill 2005, në bazë të nenit 12 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Ekonomik ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë, të nënshkruar në Vjenë më 29 mars 1994.

Delegacioni shqiptar u kryesua nga Z. Luan Shahollari, zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë të Republikës së Shqipërisë, dhe delegacioni austriak u kryesua nga Z. Josef Mayer, zëvendësministër, drejtor i Drejtorisë për Politikën e Jashtme Ekonomike dhe të Integritimit European në Ministrinë Federale të Çështjeve Ekonomike dhe të Punës të Republikës së Austrisë.

Anëtarët e të dy delegacioneve janë të shënuar përkatësisht në anekset I dhe II të këtij protokollit. Sesioni i tretë i Komisionit miratoi rendin e ditës në aneksin III.

Sesioni i tretë i Komisionit të Përbashkët u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë, miqësore dhe të mirëkuptimit reciprok, e cila pasqyronte dëshirën dhe vendosmërinë e të dy vendeve për gjetjen e rrugëve praktike, të realizueshme dhe efektive për të rritur dhe diversifikuar më tej marrëdhëniet ekzistuese në sektorët e ndryshëm të ekonomive përkatëse.

Rezultatet e bisedimeve janë të përmbledhura në vijim:

1. Shqyrtimi i gjendjes ekonomike në të dy vendet

Të dyja palët shkëmbyen informacione mbi gjendjen ekonomike në vendet e tyre përkatëse dhe ranë dakord se, nisur nga shenjat pozitive të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, mund të priten përmirësime të mëtejshme të marrëdhënieve dypalëshe ekonomike dhe tregtare.

2. Gjendja dhe zhvillimi i marrëdhënieve tregtare dypalëshe

Të dyja palët shprehën kënaqësinë për rritjen e shënuar që nga sesioni i kaluar në volumin e tregtisë dypalëshe, si edhe nënvizuan që ky volum nuk përfaqëson potencialet reale të ekonomive të të dy vendeve.

Pala shqiptare informoi palën austriake se volumi i eksportit në Austri në vitin 2004 arriti nivelin e 4,7 milionë USD, kundrejt vetëm 745 mijë USD në vitin 2002. Volumi i tregtisë midis të dy vendeve në vitin 2004 ishte 33,6 milionë USD kundrejt 19,6 milionë USD në vitin 2002, me një rritje prej 71 për qind.

Pala austriake vuri në dukje se sipas statistikave të tregtisë së jashtme austriake, në krahasim me vitin 2003, eksportet austriake drejt Shqipërisë janë rritur më tej gjatë vitit 2004 me +38,6 % në 24,4 milionë euro dhe gjithashtu importet austriake nga Shqipëria janë rritur gjatë së njëjtës periudhë me + 27,2% në 4,4 milionë euro.

Të dyja palët theksuan nevojën për të bërë përpjekje të metejshme për të rritur tregtinë dypalëshe në nivele më të larta mbi bazën e përfitimit reciprok.

Të dyja palët, në këtë drejtim, theksuan rëndësinë e vizitave të delegacioneve tregtare, organizimin e misioneve tregtare, si dhe pjesëmarrjen në panaire dhe ekspozita të organizuara në të dy vendet, dhe ranë dakord të inkurajojnë nismat e kësaj natyre.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit tregtar në të ardhmen, pala shqiptare shprehu gadishmërinë e saj për të intensifikuar kontaktet ndërmjet strukturave përkatëse të të dy vendeve.

3. Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit ekonomik dypalësh

Të dyja palët vlerësuan me kënaqësi se janë realizuar shumë nga objektivat e vendosura në protokollin e sesionit të dytë të Komisionit të Përbashkët (shtator 2002).

Të dyja palët theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ekonomik dhe përmendën se gjatë viteve të fundit pala austriake ka financuar një numër projektesh në Shqipëri, kryesisht në sektorin e furnizimit me ujë, energjisë dhe arsimit. Përparësi gjeografike i është dhënë Shqipërisë Veriore.

Me qëllim rritjen e bashkëpunimit ekonomik dypalësh në të ardhmen, pala shqiptare propozoi:

- Vendosjen e kontakteve institucionale ndërmjet tri agjencive shqiptare të krijuara së fundmi, shprehimisht Agjencia e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja Direkte dhe Agjencia e Nxitjes së Eksporteve dhe homologëve të tyre në Austri;

- Konsolidimin e marrëdhënieve midis institucioneve homologe në mbështetje të biznesit.

Prioritetet e bashkëpunimit sipas sektorëve

3.1 Turizmi

Të dyja palët theksuan rëndësinë e turizmit për ekonominë përkatëse kombëtare dhe informuan mbi rezultatet në turizëm gjatë vitit 2004.

Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet kompanive të turizmit, veçanërisht ndërmjet investitorëve.

Të dyja palët ranë dakord që të shkëmbejnë informacion në fushën e turizmit.

Të dyja palët ranë dakord të bashkëpunojnë në projektin “Turizmi në Shqipërinë e Jugut” në kuadër të projektit të Bankës Botërore “Menaxhimi i zonës së integruar bregdetare” dhe “Programi i pastrimit”.

Bashkëpunimi i Zhvillimit Austriak (OEZA) ofroi asistencë të mbështetjes së projektit në kontekst të investimeve private austriake (FDI) në sektorin e turizmit, si ndihmesë teknike në trajnimin profesional për formimin profesional në fushën e turizmit siç ishte siguruar edhe në të kaluarën.

Pala shqiptare shprehu interes për përvojën austriake në turizmin malor, si dhe gjithashtu për bashkëpunim me palën austriake në lidhje me turizmin bregdetar.

3.2 Bujqësia

Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin midis instituteve kërkimore shqiptare dhe austriake për programe të përbashkëta të zhvillimit të zonave bujqësore duke synuar rritjen e qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes, burimeve natyrore.

Pala shqiptare parashtrroi kërkesën për mbështetje dhe asistencë teknike nga pala austriake lidhur me krijimin dhe konsolidimin e shoqatave të fermerëve në bujqësi.

Të dyja palët ranë dakord për mbështetjen profesionale të fermerëve shqiptarë nga pala austriake.

Të dyja palët shprehën vlerësimin e tyre për bashkëpunimin pozitiv të Shoqatës së Dyfishtë të Rritësve të Gjedhit që prej formimit të saj në vitin 2002. Gjithashtu u theksuan edhe shërbime shtesë austriake, të tilla si oferta për këshilla shtesë (seminare, kurse, materiale informuese), si dhe ngritja e qendrave shpërndarëse të rritjes së gjedhit. Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin dhe do të

shkëmbejnë informacion në fushën e ndërzimit të gjedhit.

Pala austriake kujtoi mundësinë e trajnimit profesional në fushën e bujqësisë, mbarështimin e kafshëve, menaxhimin ujqor dhe pyjqor, në mbështetje të fermerëve në Shqipëri.

Të dyja palët ranë dakord për shkëmbimin e përvojës në fushën e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Pala shqiptare shprehu interes lidhur me sigurimin e mbështetjes nga pala austriake lidhur me përafrimin e legjislacionit për sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve.

Të dyja palët do të nxisin bashkëpunimin midis instituteve kërkimore për programe të përbashkëta, duke synuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e pyjeve (veçanërisht brenda kuadrit të Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore (NRDP)) dhe të burimeve natyrore.

3.3 Mjedisit

Pala austriake mori dijeni për nevojat e Shqipërisë rreth çështjeve të mjedisit dhe shprehu vullnetin e saj për të punuar së bashku ngushtësisht.

Të dyja palët ranë dakord të inkurajojnë kontaktet dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të tyre përkatëse në mënyrë që të punojnë mbi projekte konkrete në fushën e mjedisit.

3.4 Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme

Të dyja palët ranë dakord të forcojnë bashkëpunimin rreth çështjeve që kanë të bëjnë me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs)

Pala austriake është aktualisht e gatshme të japë ndihmesë në zhvillimin e sektorit privat të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në nivelin mikroekonomik, ashtu dhe në atë makroekonomik. Në varësi të ekzistencës së burimeve financiare austriake, mund të bashkëpunohet në intensifikimin e kontakteve dhe shkëmbimin e përvojës midis institucioneve dhe bizneseve përkatëse të të dy vendeve dhe gjithashtu në realizimin e projekteve dhe programeve të përbashkëta.

3.5 Punët publike (sektori i ujit)

Bashkëpunimi Austriak i Zhvillimit shprehu angazhimin e tij për të mbështetur më tej veprimtaritë në sektorin ujqor të bashkisë së Shkodrës. Pala austriake e informoi delegacionin shqiptar që negociatat tripalëshe pritet të fillojnë nga fillimi i vitit tjetër. Mbështetur në një studim që aktualisht është ndërmarrë nga KfW-Kreditanstalt für Wiederaufbau (Gjermani), Bashkëpunimi Austriak i Zhvillimit, së bashku me palën shqiptare dhe KfW do të diskutojnë për mundësinë e mbështetjes së mëtejshme të projektit të financuar nga Austria.

Të dyja palët ranë dakord për bashkëpunim të mëtejshëm në këtë fushë.

3.6 Transporti

Të dyja palët vlerësuan takimin e Komisionit të Përbashkët shqiptaro-austriak mbi transportin rrugor, të zhvilluar muajin e kaluar në Vjenë, gjatë të cilit u negociua dhe përafrua një Marrëveshje e re mbi Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave.

Pala shqiptare ftoi firmat austriake që të marrin pjesë në tenderat ndërkombëtarë që do të zhvillohen lidhur me infrastrukturën rrugore, porteve dhe aeroporteve.

Pala shqiptare kërkoi asistencë nga pala austriake në fushën e standardeve dhe kushteve teknike në infrastrukturën e transportit, si dhe trajnime eventuale në këtë drejtim.

Të dyja palët theksuan nevojën e një bashkëpunimi më të madh në fushën e transportit hekurudhor sipas drejtimeve dhe fushave të përcaktuara në Marrëveshjen ndërmjet Ministrisë të Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë Federale e Shkencës dhe Transportit të Republikës së Austrisë në lidhje me bashkëpunimin në fushën e sistemit hekurudhor”, të nënshkruar në Vjenë më 9 korrik 1998.

Të dyja palët ranë dakord që ky bashkëpunim të fokusohet në modernizimin e terminalit të Shkodrës për transportin e udhëtarëve, në rikonstruksionin e linjës hekurudhore Vorë-Shkodër- kufiri me Malin e Zi, si dhe në furnizimin e Hekurudhës Shqiptare me pajisje dhe mjete për mekanizimin e mirëmbajtjes hekurudhore.

3.7 Energjia

Pala austriake informoi palën shqiptare që aktualisht është duke u përgatitur nga Agjencia Austriake e Zhvillimit (ADA) një ofertë për të mbështetur edhe më tej projektin e rehabilitimit të kaskadës së lumit Drin. Oferta përmban një mbështetje financiare që arrin në dy milionë euro. Paketa

financiare përbëhet nga një element granti (në nivelin 0,7 milionë euro) dhe nga një element kredie (1,3 milionë euro).

Pala shqiptare shprehu interes lidhur me:

- Bashkëpunimin për zhvillimin e burimeve të energjive të rinovueshme, si burimet hidrike, të diellit dhe të erës në Shqipëri;
- vijimin e bashkëpunimit në fushën e kërkimit të naftës dhe të gazit në Shqipëri;
- pjesëmarrjen e kompanive austriake në proceset e privatizimit të sektorit të energjisë (naftë, gaz dhe energji elektrike) në Shqipëri;
- nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kërkimore-shkencore të të dy vendeve.

Pala austriake, duke qenë e ngarkuar/përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut dhe legjislacionit në çështjet e inxhinierisë elektrike, ku përfshihen rregullat kombëtare dhe përafrimi i legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE-së (Direktiva e Voltazhit të Ulët, Direktiva EMC, Direktiva ATEX, si dhe Direktivat e Etiketimit të Energjisë dhe e Efektivitetit të Energjisë), mund të ofrojë mbështetje në hartimin e legjislacionit përkatës në Shqipëri në pajtim me kërkesat e BE-së për premiset në drejtim të rritjes së tregtisë në këtë sektor.

3.8 Minierat dhe gjeologjia

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit në fushën e minierave dhe të gjeologjisë.

Në fushën e minierave, pala shqiptare shprehu interes për bashkëpunim në fushat e poshtëshënuara:

- Mbrojtja dhe rehabilitimi i mjedisit në zonat e shfrytëzuara të mineraleve si, bakri, kromi, qymyrguri etj.
- Përpunimi i materialeve të ndërtimit me karakteristika të larta cilësore.
- Shfrytëzimi i gurëve dekorativë;

Pala shqiptare propozoi vendosjen e kontakteve të rregullta ndërmjet shërbimeve gjeologjike respektive.

3.9 Financat

Të dyja palët vlerësuan fillimin e negociatave teknike lidhur me Marrëveshjen për mënjanimin e taksimit të dyfishtë, eliminimin e evazionit fiskal, bashkëpunimin në fushën e doganave dhe në luftën kundër pastrimit të parave.

Lidhur me sektorin bankar, të dyja palët theksuan rëndësinë e privatizimit të Bankës Shqiptare të Kursimeve nga Banka Austriake “Raiffeisen Bank”.

Të dyja palët ranë dakord që të forcojnë bashkëpunimin në fushat e poshtëshënuara:

- luftën kundër pastrimit të parave;
- përfundimin e marrëveshjes për mënjanimin e taksimit të dyfishtë;
- arritjen e një marrëveshjeje binjakëzimi midis ministrave respektive të dy vendeve për shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira në fushën e financave publike.

3.10 Programi Austriak për Zhvillim

Të dyja palët theksuan rëndësinë e Programit Austriak për Zhvillim me vendet e Europës Juglindore. Reduktimi i lëvizjeve të pakontrolluara dhe dhënia e një kontributi në përmirësimin e ekuilibrit social përbëjnë synimet kryesore të këtij Programi për Shqipërinë. Programi Austriak për Zhvillim do të veprojë në vijimësi në Shqipëri lidhur me përmirësimin e infrastrukturës, krijimin e vendeve të punës, forcimin e strukturave administrative lokale dhe modernizimin e shoqërisë.

4. Marrëdhëniet Shqipëri-BE

4.1 Zhvillimet në kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe Asocimit

Të dyja palët ranë dakord se Procesi i Stabilizim-Asocimit (PSA) në Shqipëri është intensifikuar që nga hapja zyrtare e negociatave ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit European për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit më 31 janar 2003, si dhe me miratimin e dokumentit të Partneritetit European më 14 qershor 2004. Deri tani, janë organizuar 14 raunde negociatash dhe është përfunduar “leximi i parë” i tekstit të Marrëveshjes.

Pala shqiptare informoi se në përgjigje të Partneritetit European, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ka miratuar Planin Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Prioriteteve të Partneritetit European më 30 gusht 2004. Plani i Veprimit identifikon masat prioritare që duhet të ndërmerren me qëllim realizimin e objektivave prioritare në kuadër të SAP-së brenda një periudhe

afatshkurtër (1-2 vjet) dhe një periudhe afatmesme (3-4 vjet).

Të dyja palët ranë dakord të inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve respektive shqiptare dhe austriake drejt përshtetimit të procesit të integritetit të Shqipërisë në strukturat e BE-së.

4.2 Bashkëpunimi në kuadrin e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore

Të dyja palët nënvizuan rëndësinë e mbështetjes financiare austriake për bashkëpunimin rajonal (kryesisht në kuadrin e Paktit të Stabilitetit), e cila i shërben lidhjes së Shqipërisë me vendet e tjera të Europës Juglindore. Mbështetja e bashkëpunimeve rajonale synon arritjen e stabilitetit të qëndrueshëm, zhvillimin ekonomik dhe integritetin e rajonit në strukturat europiane. Shembuj projektesh të tilla janë Investment Compact (Mbështetja e sektorit privat), ERISSE (Task Force Education and Youth), si dhe Balkan Case Challenge, një konkurs i përvitshëm për studentët nga Jugu i Europës.

Pala shqiptare vlerësoi kontributin e Austrisë si bashkëkryesuese e Nismës së Kompaktit të Investimeve, e cila si komponent kyç i Paktit të Stabilitetit (në bashkëpunim me OECD), luan një rol të rëndësishëm në proceset transformuese në vendet e rajonit, veçanërisht në nxitjen e investimeve. Gjithashtu, të dyja palët shënuan rëndësinë e aktivitetit në nivel ministrior të Kompaktit të Investimeve, i cili zhvillohet çdo vit në Vjenë. Deklarata Ministrore e Vjenës e korrikut 2004 vuri theksin në rritjen e fluksit të investimeve të huaja. Në këtë kontekst, të dyja palët nënvizuan progresin e Shqipërisë, ku investimet e huaja në vitin 2004 kapën shifrën 341 milionë USD përkundrejt 178 milionë USD të vitit 2003.

4.3 Regjimi tregtar rajonal – Marrëveshjet e tregtisë së lirë

Të dyja palët theksuan se e konsiderojnë integritetin rajonal në Europën Juglindore si një politikë që konsolidon rritjen ekonomike të qëndrueshme në vendet e rajonit dhe si një parakusht të integritetit të këtyre vendeve në Bashkimin Europian.

Në këtë kontekst, pala shqiptare informoi palën austriake lidhur me përfundimin e tetë marrëveshjeve të tregtisë së lirë, të cilat janë tani në fazën e zbatimit. Si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve, janë rritur eksportet shqiptare në vendet e rajonit.

4.4 Projekti rajonal CARDS (sektori i drejtësisë)

Projekti CARDS rajonal “Krijimi i një sistemi gjyqësor të pavarur, të besueshëm dhe funksional dhe forcimi i bashkëpunimit gjyqësor në vendet e Ballkanit Perëndimor” ka filluar veprimtarinë që prej muajit maj 2004 nën drejtimin e Ministrisë Federale Austriake të Drejtësisë. Projekti prej 5,5 milionë euro do të vihet në jetë brenda tre vjetëve të ardhshëm, në bashkëpunim me ministrinë e drejtësisë të disa vendeve europiane, si dhe të Këshillit të Europës.

5. Gjendja lidhur me OBT

Pala austriake nënvizoi që marrëveshja e vendeve anëtare të OBT-së mbi të ashtuquajturën “Paketa e Korrikut” ishte një sinjal shumë pozitiv dhe inkurajues për politikën ekonomike shumëpalëshe; sidoqoftë, për të pasur një përparim të shpejtë, të gjitha përpjekjet duhen përqendruar në negociatat që po zhvillohen aktualisht. Në lidhje me përgatitjet për Konferencën e ardhshme Ministrore në Hong Kong, do të ishte e rëndësishme që të arrihej përqasja e parë rreth çështjeve themelore deri në muajin qershor 2005, në mënyrë që të shtrohej rruga për përfundimin me sukses të saj.

Pala shqiptare informoi se, me pranimin në OBT në shtator të vitit 2000, Qeveria shqiptare plotësoi me sukses një nga objektivat më të rëndësishme të ekonomisë shqiptare, duke bërë të mundur në këtë mënyrë pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në regjimin tregtar shumëpalësh. Anëtarësimi në OBT dhe zbatimi i angazhimeve përkatëse pasqyrojnë përpjekjet e Shqipërisë për të arritur standarde ekonomike që synojnë ta bëjnë atë anëtarë të Bashkimit Europian. Objektivi kryesor i Qeverisë shqiptare është sigurimi i një pozicioni korrekt në këtë organizatë nëpërmjet zbatimit rigoroz të angazhimeve që rrjedhin nga anëtarësimi.

Çështje shqiptare dhe austriake

Data dhe vendi i sesionit të ardhshëm

Të dyja palët vendosën që të mbajnë sesionin e katërt të Komisionit të Përbashkët shqiptaro-austriak për bashkëpunimin ekonomik në Tiranë, në një datë e cila do të përcaktohet në rrugë diplomatike.

Bërë dhe nënshkruar më 12 prill 2005 në Vjenë, në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhën angleze, të dy tekstet njëjloj të vlefshme.

Për delegacionin shqiptar	Për delegacionin austriak
Z. Luan SHAHOLLARI Zëvendësministër i Ministrisë së Ekonomisë	Z. Josef MAYER Zëvendësministër Drejtore i Drejtorisë për Politiken e Jashtme Ekonomike dhe të Integrimit European